



REPUBLIKA E SHQIPERISE
ENTI RREGULLATOR I ENERGJISE

VENDIM

Nr. 17 Datë 31.01.2013

MBI

**SHTYRJEN E ANKANDIT VJETOR TË KAPACITETEVE TË
INTERKONJEKSIONIT PËR VITIN 2013**

Në mbështetje të nenit 8, pika 2, gërma “ç”, paragrafi “ii”, dhe 9, të Ligjit nr. 9072, datë 22.05.2003, “Për Sektorin e Energjisë Elektrike”, të ndryshuar, pikës 7, gërma “b”, të Modelit të Tregut të Energjisë Elektrike të miratuar me Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr. 338, datë 19.3.2008, të ndryshuar, VKM nr. 924, date 26 Dhjetor mbi “Lejimin e shoqërisë KESH sh.a, të importojë energji elektrike për periudhën 1.01.2013 deri 1.03.2013 për furnizimin e konsumatoreve tarifore dhe mbulimin e humbjeve në sistemin e shpërndajës”, Bordi i Komisionerëve të ERE-s në mbledhjen e tij të datës 31.01.2013, mbasi shqyrtoi relacionin e Drejtorisë Juridike dhe Mbrojtjes së Konsumatorit dhe Drejtorisë së Liçensimit dhe Monitorimit të Tregut,

Vendosi:

1. OST sh.a të shtyjë zhvillimin e ankandit vjetor për kapacitetet ndërkufitare të interkonjeksionit për vitin 2013, në drejtim importi, deri në datë 22.02.2013.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI

Sokol RAMADANI